



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.254/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e cila identifikohet me shenjë ZL.Anr.254/2017 e paraqitur me datë 18.10.2017 me të cilën kërkohet që subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 18.10.2017 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 18 tetor 2017, LVV ka planifikuar të mbaj tubim publik me qytetar në sheshin e Lidhjes në Prizren, mirëpo pranë tubimit ishte vendosur një tendë me material zgjedhor nga radhët e AKR-së. Aktivistët e tyre kanë komunikuar me aktivistët e AKR-së për të larguar tendën pasi që LVV ka marrur leje nga Kuvendi Komunal Zgjedhorë (KKZ) për atë tubim. Pastaj aktivistët e LVV-së kanë thirrur KKZ ku ata kanë mohuar se i kanë dhënë leje AKR-së për vendosjen e tendës dhe po ashtu edhe aktivistët e AKR-së e kanë pohuar se nuk kanë leje. Po ashtu LVV për këtë rast e kanë njoftuar edhe policin të cilët nuk i kanë larguar aktivistët e AKR-së.

Me këtë rast, parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 4.1 i Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi, dhe pëlqimin e lëshuar nga KKZ për mbajtjen e tubimit.

Në përgjigjen në ankesë të datës 19.10.2017, subjekti politik AKR thekson se ankesa e bërë ndaj tyre nga subjekti politik LVV është e pabazuar, për arsye se AKR në Prizren e ka vendosur shtabin mobil në rrugën “Jusuf Gërvalla” në Prizren, pasi që paraprakisht e ka

siguruar pëlqimin nga organet kompetente në Prizren. Po ashtu në përgjigje kanë theksuar se subjekti i tyre në asnjë moment nuk ka për qëllim pengimin e aktiviteteve të subjekteve tjera politike për zhvillimin e fushatës zgjedhore. Kështu që tenda e venosur në Sheshin e Lidhjes në Prizren nuk qëndron më aty, pasi që aktivistët e tyre nuk e kanë parë të arsyeshme të vazhdojnë më tepër me atë mënyrë të fushatës.

AKR si dëshmi, përgjigjes i ka bashkangjitur pëlqimin e lëshuar nga KKZ në Prizren.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat lëndës konform dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, konstatoj se :

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), ka shkelur rregullat zgjedhore pasi që kanë vendosur tendë pa leje, me material zgjedhor në Sheshin e Lidhjes së Prizrenit dhe me këtë rast kanë penguar subjektin LVV në mbajtjen e tubimit të tyre, Paneli i vlerësoi si të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, ngase nga dëshmitë e ofruara si provë nuk mund të vërtetohen pretendimet e tilla se subjekti politik LVV, nuk e ka mbajtur fushatën zgjedhore si pasojë e vendosjes së tendës nga subjekti politik AKR, se subjekti politik AKR me ndonjë veprim ka penguar parashkruesin e ankesës që ta mbajnë aktivitetin e tyre zgjedhor. Andaj për rrjedhojë Paneli konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 117.3 i LZP-së sipas të cilit : *Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.* Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij ashtu siç parashihet me nenin 117 par.3 të LZP-së në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuara më dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Zl.Anr. 254/2017 me datën 22.10.2017



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.